



Ndërmarrja Publike Qendrore  
Posta e Kosovës Sh.A.



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIM**  
**PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE POSTARE**  
**(SHPËRNDARJA E DËRGESAVE/GJOBAVE TË TRAFIKUT RAJONAL)**

Kjo marrëveshje lidhet në mes të:

1. **POSTA E KOSOVËS Sh.A.** adresa, rruga "28 Nëntori", nr.4, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Me numër unik identifikues:811285205, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor znj. **Nora Rraci** - Kryeshefe Ekzekutive, në tekstin e mëtejme: Kryesi i Shërbimeve, dhe,
2. **KOMUNA E GLLOGOCIT** adresa, rruga "Besim Mala", 13000, Gllogoc, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. **Ramiz Lladrovci** - Kryetar i Komunës së Gllogocit, në tekstin e mëposhtëm: Porositësi i Shërbimeve, dhe,
3. **POLICIA E KOSOVËS** adresa, rruga "Besim Mala", 13000, Gllogoc, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. **Driton Morina** – Komandant i Stacionit Policor në Gllogoc, në tekstin e mëtejme : Ndërmjetësues i Shërbimeve.

**NDËRSA:**

Duke marrë parasysh konsideratat dhe kushtet e premtimet reciproke të parashtruara këtu, personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Marrëveshje kryerjen e shërbimeve Postare i identifikuar si, "Kryesi i Shërbimeve", personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi si "Porositësi i Shërbimeve" dhe personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi si "Ndërmjetësues i Shërbimeve " bien dakord që të lidhet marrëveshje si vijon:

*pi*

**Marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e shërbimeve postare – PRANIM / PËRPUNIM** (Ndërmjetësues i Shërbimeve) - **SHPËRNDARJA E DËRGESAVE / GJOBAVE TË TRAFIKUT RRUGOR NË ADRESË TË GJOBITURËVE** (Kryesi i Shërbimeve), sipas marrëveshjes me (Porositësi i Shërbimeve).

## **1. PËRKUFIZIME**

Në këtë marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

**MARRËVESHJE** : do të thotë kjo marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e shërbimit postar.

**AFAT** : ka kuptimin e dhënë në Nenin 2.

**KRYESI I SHËRBIMEVE** : do të thotë : Posta e Kosovës Sh.A.

**POROSITËSI I SHËRBIMEVE** : do të thotë: Komuna e Gllogocit

**NDËRMJETSUESI I SHËRBIMEVE** : do të thotë: Policia e Kosovës

**OPERATOR PUBLIK POSTAR** : person juridik (Posta e Kosovës Sh.A) i licencuar për ofrimin e shërbimeve universal postare.

**SHËRBIM POSTAR** : Shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të postës së letrave, pakove, urdhërpagesave si dhe shërbimet e kryera me pagesë të cilat sigurohen nëpërmjet mjeteve për pranimin dhe dërgimin e dërgesave postare.

**SHËRBIM UNIVERSAL POSTAR** : Një minimum të përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, me çmime të përballueshme, i mundshëm përherë, në të gjitha pikat, për të gjithë shfrytëzuesit në territorin e Republikës e Kosovës;

**SHËRBIM I VEÇANTË POSTAR** : shërbimet me të cilat dërguesi kërkon mënyrë të veçantë të dërgimit, bartjes dhe dorëzimit të dërgesës, ndryshe quhen dërgesat të regjistruara, (dërgesë e porositur "R", dërgesë me lajmërim marrje "LM", dërgesë me kundërpagesë, shërbimi i shpejtë postar "EMS", etj).

**GJOBAT TË TRAFIKUT RRUGOR** : do të thotë, gjobat të shqiptuara pronarëve të veturave nga Policia e Kosovës për kundërvajtje në trafikun rrugor, brenda komunës përkatëse.

**ZYRË POSTARE** : hapësirën punuese në të cilën operatori postar ofron shërbime postare dhe shërbimet e IFjB/pagesat.



**TARIFA POSTARE :** ka kuptimin e çmimorës në fuqi së shërbimeve postare, të aprovuar nga rregullatori ARKEP.

**PERSONAT KONTAKTUES :** ka kuptimin e personit me të cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e mirëfilltë të kësaj kontrate.

## **2. AFATI I BASHKËPUNIMIT**

2.1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi fillon në datën e nënshkrimit të saj, dhe vlenë me nënshkrimin e të tre (3) palëve kontraktuese dhe është e vlefshme për një periudhë kohore (3) vjeçare, deri me **31/12/2027** me mundësi vazhdimi, përveç rastit kur është fjala për zgjidhje të parakohshme të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, sipas marrëveshjes së palëve bashkëpunuese.

2.2. Zgjidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit është e mundur edhe nëse dispozitat ligjore mbi shërbimet postare e parashohin një mundësi të tillë.

2.3. Nga Porositësi i Shërbimeve, kontaktet do të bëhen nga Drejtoria e Administratës.

2.4. Nga Kryesi i Shërbimeve znj. [Vlora .Thaqi@postakosoves.com](mailto:Vlora.Thaqi@postakosoves.com), zyrtare përgjegjëse për përcjelljen, kujdesin dhe menaxhimin e zbatimi të kontratës nr. tel; +38344587875, apo edhe nga **Shitja - PK. Sh.A**, nr. tel; 038534478 .

2.5. Nga Ndërmjetësuesi i Shërbimeve kontaktet do të bëhen nga Zyra Ligjore, Divizioni i Trafikut Rrugor dhe Drejtoria për buxhet dhe Financa.

## **3. DETYRIMET E PALËVE**

3.1. Palët e kësaj marrëveshje bashkëpunimi janë pajtuar që lënda e marrëveshjes të jetë: **Pranim/Përpunimi i e-Tiketave (gjobave) dhe Shpërndarja përmes shërbimit postar të veçantë me Lajmërim Marrje (LM), më përmbajtje gjoba nga trafiku rrugor të shqiptuara nga Policia e Kosovës për shkeljen e rregullave të komunikacionit rrugor në territorin administrativ të Komunës së Glllogocit, duke i dorëzuar ato në adresat e marrësve/në adresën sipas shënimit në zarfin nga Policia e Kosovës.**

3.2. Kryesi i Shërbimit do të bëjë tërheqjen e dërgesave/gjobave tek ndërmjetësuesi i shërbimit në pikat e përcaktuara nga Policia e Kosovës, sipas listës së përpiluar nga ndërmjetësi i shërbimit (Policia) dhe pëlqimit të Porositësit të shërbimit (Komuna Glllogocit) për shpërndarje dhe dorëzim nga ana e kryesit të shërbimit (Posta).

3.3. Kryesi i shërbimit do të bëjë edhe sigurimin e plikove (zarfeve) me logon e ndërmjetësit (Policisë së Kosovës) në çdo kohë dhe sipas nevojës pa ndonjë kosto.

3.4. Ndërmjetësi i shërbimit dhe kryesi i shërbimeve obligohen të bëjnë pranimin-dorëzimin e dërgesave postare nëpërmjet formularit të ndërmjetësit apo edhe me Librit të pranimi (formular i kryesit të shërbimit).

3.5. Porositësi i shërbimit përmes Postës së Kosovës në mënyre alternative mund të siguroj çdo ngarkesë edhe online përmes web faqes [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com), në rubrikën KLIENTËT (regjistrimi i dërgesave), modul i veçantë për institucione.

3.6. Kryesi i shërbimeve obligohet që dërgesat postare t'i dorëzojë në afat në adresën e marrësit, sipas procedurave të parapara ligjore dhe udhëzimeve mbi pranim-dorëzimin e dërgesave postare me shërbim (LM), ndërsa për dërgesat postare të pa dorëzuara, pas afateve për tërheqje dhe ruajtje i kthehen ndërmjetësuesit të shërbimeve të vulosura dhe me arsye të konstatuara për mos dorëzim.

3.7. Kryesi i shërbimeve obligohet që t'i regjistroj dhënat në librin e pranimi (form. P-2) përmes aplikacionit të saj (SASP) me të dhënat e shënuara në dërgesa (dërgesa postare) nga ndërmjetësuesi i shërbimeve dhe të shënojë taksën për secilën dërgesë. Një (1) kopje i dërgohet Komunës dhe një (1) kopje Policisë në mbarim të çdo muaji.

3.8. Porositësi i shërbimit, përmes ndërmjetësit Policisë së Kosovës dorëzon të gjitha dërgesat postare me përmbajtje gjoba (e-tiketa) nga trafiku kryesit të shërbimit përmes ekipeve mobile në terren të Postës regjioni Glllogocit.

3.9. Ndërmjetësi i shërbimit obligohet që në dërgesat e veta nuk do të vej materie dhe sende bartja e të cilave është e ndaluar sipas Ligjit mbi shërbimet postare.

3.10. Palët bie dakord për të trajtuar të gjitha të dhënat personale të cilat i janë shpalosur atyre në vijim të zbatimit të lëndës së marrëveshjes, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të përdorë ato vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj marrëveshje.

#### 4. KUSHTET E PAGESËS

4.1. **Kryesi i shërbimeve** për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj marrëveshje bashkëpunimi përmes faturës ja faturon taksën në fund të muajit për muajin paraprak në pajtim me tarifën postare në fuqi të aprovuar nga ARKEP për llojin e shërbimit të kërkuar nga **porositësi i shërbimi**, në këtë rast shërbimi i veçantë me lajmërim marrje (LM) peshë deri 50 gr. ( tarifa aktuale në fuqi 1.70 €), dhe për dërgesa të pa dorëzuar (tarifa për çmimin bazë 0.50€). Ndërsa ndërmjetësuesi nuk paguan asnjë shërbim apo produkt në bazë të kësaj marrëveshje.



4.2. Kryesi i shërbimeve obligohet të siguroj zarfa me logo të Policisë për ndërmjetësin e shërbimeve, të pranoj dërgesat e përpunuara nga ndërmjetësi i shërbimeve në pikat ku përpunohen e-tiketa e gjobave.

4.3. Në rastet ku gjatë afatit të marrëveshjes së bashkëpunimit tre palësh me ndonjë vendim institucional nga rregullatori apo operatori publik kemi ndryshim të tarifave të shërbimeve postare, porositësi i shërbimit obligohet që të paguaj faturat sipas tarifave të ndryshuara.

4.4. Porositësi i shërbimit obligohet që pagesën për taksën postare dhe shërbimin e kryer të bëjë në llogarinë bankare të Postës së Kosovës SH.A. sipas faturës së dorëzuar, në afat ligjor prej 30 ditëve me shenjë për të hyrat e "Posta e Kosovës SH.A"., nëse pagesa nuk kryhet pas afatit ligjor prej 30 ditëve, Kryesi i shërbimeve mund të ua ndërprerje shërbimet postare dhe inicioj procedurat përmbartimore.

4.5. Kryesi i shërbimeve postare kryen shërbimet postare sipas tarifës/çmimorës në fuqi të miratuar nga **ARKEP-i** (Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), të cilën mund të gjeni në ueb - faqen: [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com).

## 5. ZGJIDHJA E MARREVESHJES

5.1. Marrëveshja fillon me rastin e nënshkrimit nga të tre (3) palët dhe është e vlefshme në afat prej tre vite, me mundësi vazhdimi. Para skadimit të afatit të marrëveshjes 30 ditë përpara duhet të shqyrtojnë mundësinë e vazhimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, me kërkesën paraprake me shkrim për vazhdim nga ana e palëve të marrëveshjes së bashkëpunimit.

5.2. Palët në marrëveshje bashkëpunimi mund të zgjidhin marrëveshjen edhe para përfundimit të afatit në pikën 2.1. duke e njoftuar njëra tjetrën se nuk dëshirojnë të vazhdojnë bashkëpunim, me kërkesën me shkrim 30 ditë përpara.

5.3. Secila palë mund të ndërpresë njëanshëm bashkëpunimin për kryerjen e shërbimeve, brenda afatit të marrëveshjes së bashkëpunimit tre palësh, kurdo që e vlerësojnë se ka efekte negative afariste, duke njoftuar njëra tjetrën me shkrim brenda afatit prej 30 ditësh.

## 6. NDRYSHIM STATUSIT

6.1. Kryesi i Shërbimeve rezervon të drejtën e plotë të transferojë këtë marrëveshje në rastin e ndryshimit të pronësisë pasardhësve të tij ose ndonjë subjekti të tij ndaj çdo Kompanie, pa qenë nevoja të marrë miratimin e Porositësit dhe Ndërmjetësit të Shërbimeve, përveç kur është rasti i privatizimit të PK Sh.A., dhe ky transferim do të bëhet efektiv në datën kur Kryesi i Shërbimeve i jep njoftim Porositësit dhe Ndërmjetësit të Shërbimeve.

6.2. Ndryshimet ndaj kësaj marrëveshje mund të bëhen vetëm me shkrim, me nënshkrime të përfaqësuesve të autorizuar të secilës palë ose pasardhësve të tyre.

6.3. Çdo çështje e pa trajtuar në këtë Marrëveshje do të zgjidhet me pajtimin dhe shqyrtimin e palëve në marrëveshje në përputhje me Ligjin mbi Shërbimet Postaren në fuqi.

## **7. PËRGJEGJËSIA**

7.1. Operatori publik Postar, të gjitha shërbimet nga veprimtaria e tij, do ti trajtoj në përputhje me Ligjin për shërbime Postare Nr. 06/L-038, dhe Rregulloren për Autorizimin e përgjithshëm për Ofrimin e shërbimeve Postare Nr.41 me Nr. protokoli 041/B/19 dhe Rregulloren për Ofrimin e shërbimit Postar Nr.44 me Nr. protokoli 123/B/2019.

7.2. Shërbimi postar ndërkombëtar realizohet në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji, aktet e Unionit të Përgjithshëm Postar dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me shërbimet postare.

7.3. Kryesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar mbi pajisjet për shkak të akteve ose mosveprimeve të tij nga pakujdesia keq shfrytëzimi ose keqpërdorimi prej anëtarëve të personelit të tij i natyrës penale, qoftë ky i prekshëm ose i paprekshëm në secilin prej rasteve të lartpërmendura që ndodh gjatë përmbushjes ose në lidhje me përmbushjen e kësaj marrëveshje . Kryesi i Shërbimeve nuk mban përgjegjësi nëse këto janë të natyrës që përshkruhet në Nenin 8 (Forcë Madhore).

7.4. Çdo dërgesë postare që është objekt reklamacioni do të trajtohet sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në kohën e paraqitjes së reklamacionit.

## **8. FORCA MADHORE**

8.1. Nëse, në çdo kohë, gjatë afatit të kësaj marrëveshje përmbushja plotësisht ose pjesërisht nga secila palë e çdo detyrimi sipas kësaj marrëveshje pengohet ose vonohet për shkak të luftës, luftës civile, armiqësisë, akteve të armikut publik, rebelimit, revolucionit, fuqisë ushtarake ose të uzurpimit, shqetësimeve civile, demonstratave ose kërcënimeve të menjëhershme lidhur me gjithë si më lart, sabotazhit, zjarrit, përmytjes, shpërthimeve të epidemive dhe pandemive, kufizimeve për shkak të karantinës, shqetësimeve në furnizime nga burime normalisht të besueshme (ku përfshihen por jo vetëm elektricitet, ujë, naftë dhe të ngjashme), greva, përjashtime, vendime qeveritare ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës në fjalë (këtu e më poshtë e përmendur si "ndodhia"), atëherë përmbushja e këtyre detyrimeve do të falet në masën që u pengua ose u vonua dhe pala e prekur ka marrë njoftim për këtë ndodhi nga Pala tjetër brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga Marrëveshje: Posta e Kosovës - Policia e Kosovës - Komuna e

Glllogocit data e ndodhisë duke pasur parasysh që ngjarja e çdo ndodhie nuk justifikon asnjë detyrim të secilës Palë për të kryer pagesa. Asnjëra Palë, për shkak të ndodhisë, nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje ose të ngrejë pretendime për dëme kundër palës tjetër në lidhje me mos-përbushjen ose vonesën në përbushje. Përbushja e detyrimeve të cenuara duhet të rifillojë apo të jetë praktike pas përfundimit ose pushimit të ndodhisë në fjalë. Nëse përbushja tërësisht ose pjesërisht e ndonjë detyrimi sipas kësaj marrëveshje bashkëpunimi vonohet për shkak të ndonjë ndodhie të tillë për një periudhë që tejkalon tre (3) muaj, Palët do të takohen dhe rishikojnë në mirëbesim dëshirueshmërinë dhe kushtet për zgjidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit tre palësh.

## **9. MARRËVESHJA E PLOTË**

9.1. Palët pohojnë dhe bien dakord se gjithë marrëveshjet dhe mirëkuptimet mes tyre marrin fund që prej datës efektive të kësaj marrëveshje bashkëpunimi: me kusht, që të gjitha shumatat që përbëjnë detyrim ndaj secilës Palë sipas marrëveshjes së mëparshme mbeten ende detyrime dhe të pagueshme.

## **10. LIGJI DHE JURIDIKSIONI**

10.1. Kjo marrëveshje qeveriset nga Ligji Kosovar, dhe është nën juridiksionin e Gjykatës kompetente.

10.2. Në rast të çdo mosmarrëveshjeje që lind për shkak ose në lidhje me përbushjen ose interpretimin e kësaj marrëveshje, Palët bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes do ta marrë gjykata kompetente e Glllogocit.

10.3. Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale, një (1) për palët kontraktuese, dy (2) për PK Sh.A.



**NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË KRYESIT TË SHËRBIMEVE**



[Signature]  
z.ij. Nora Rraci - Krye shëf Ekzekutiv, PK SH.A.

Datë: 15/07/2025

**NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË POROSITËSIT TË SHËRBIMEVE**



[Signature]  
z. Ramiz Lladrovci - Kryetar i Komunës së Glllogocit

Datë: 02/06/2025

**NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË NDËRMJETËSUESIT TË SHËRBIMEVE**



[Signature]  
Nënkolonel Basri Shabani - Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë

Datë:     /     /